



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të përcaktuara me nenin 63.4, nenin 42 të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenit 21.1 të Ligjit për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit nr. 174 për Financimin e Subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar nr. 04/L-058, nenit 4 të Rregullës Zgjedhore nr. 12/2013 Kufizimi i Shpenzimeve të Fushatës dhe Deklarimi Financiar dhe nenit 1.4 të Rregullës nr.14/2013 Mbi Financimin e Subjekteve Politike dhe Sanksionet, Komision Qendror i Zgjedhjeve me date 02.03.2018 merrë këtë:

VENDIM

Për shqiptimin e gjobës

- Partia Politike, “Strank Demokratske Akcije– SDA“, gjobitet për dorëzim me vones të Raportit të Deklarimit Financiar të Fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale të mbajtura më datës 22 tetor 2017.
- Shuma e gjobës llogaritet duke përfshirë gjoben bazike me një mijë (1000) Euro dhe gjobën ndëshkuese ditore prej 0.01 % të shumë së gjobës bazë, gjoba totale 1,007.60€.
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i transferon të gjitha pagesat e gjobave në Buxhetin e Republikës së Kosovës.
- Obligohet zyra që ta njoftoj perfaqesuesin e partise politike “Strank Demokratske Akcije – SDA“, për marrjen e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn fuqi me datën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e saj të radhes ka marre vendim që të gjobite partine politike “ Strank Demokratske Akcije – SDA”, e cila nuk e ka dorëzua raportin e deklarimit financiar të fushatës, sipas afatit

ligjor, respektivisht sipas nenit 40 të ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Afati për dorëzim të raportit të deklarimit financiar të fushatës është jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë kalendarike pas ditës së zgjedhjeve, respektivisht ky afat ka qenë deri më datë 6 dhjetor 2017.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duke u bazuar në të dhënat e lartcekura dhe duke u bazuar në nenin 21 të Ligjit për financimin e SP-ve dhe nenin 13 të Rregullës nr. 14/2015 Mbi Financimin e Subjekteve Politike dhe Sanksionet, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetare e KQZ-së



Valdete DAKA